

KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES


Nr. 31, datë 30.10.2020

“Mbi shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 311, datë 29.04.2011 “Për miratimin e Rregullores për procesin e verifikimit”, dhe të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 312, datë 29.04.2011 “Për miratimin e Udhëzimit për procesin e verifikimit”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pikat 2 dhe 3, të nenit 25, shkronjat “dh” dhe “e”, të nenit 43, pika 1, shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 53, pika 6 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka”, i ndryshuar, të miratuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, të Udhëzimit nr. 4188, datë 1.9.2016 “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit” të miratuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 6, të nenit 8, pika 3 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, si dhe të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Sektorit të Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 311, datë 29.04.2011 “Për miratimin e Rregullores për procesin e verifikimit” dhe të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 312, datë 29.04.2011 “Për miratimin e Udhëzimit për procesin e verifikimit”.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për miratimin e Manualit për procesin e verifikimit në subjektet anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.



KËSHILLI DREJTUES

3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar